AVOKATI I POPULLIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i AdministratësSeksioni i Administratës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax:+355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Tiranë 08/05/2023

Nr. K1/B15-6 Prot.

Nr.dok. 202201306/6

Lënda: *Rekomandohet trajtimi i kërkësës/ankesës së qytetarit për të vënë në vend të drejtën e kthimit të shumës së paguar për llogari të Bashkisë Kukës.*

BASHKISË KUKËS

I nderuar Z. Kryetar!

Institucioni i Avokatit të Popullit, në funksion të ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të shtetasve, nga veprimet ose mosveprimet e organeve të administratës publike, ka marrë për shqyrtim ankesën e qytetarit B. D., banues në, Kukës.

Në ankesën e z. D. trajtohet problematika e moskthimit të shumës prej 53,900 lekësh (pagesë për truall) të derdhura në llogarinë e Bashkisë Kukës.

Konkretisht qytetari na bën me dije se:

Së bashku me katër fqinj, kanë ndërtuar një shtesë pallati rreth 40 m^2 në një lagje të qytetit, me miratimin e Bashkisë Kukës. Pas ndërtimit të shtesës ankuesi bashkë me fqinjët kane likuiduar detyrimet përkatësë për truallin në masën 53,900 lekë. Por më pas Bashkia Kukës nuk ka pranuar të lidhë kontratën e shit-blerjes së truallit. Në vitin 2021, qytetarët i janë drejtuar Kadastrës Kukës **dhe kanë kryer përsëri proçedurat përkatësë dhe, pasi kanë shlyer përsëri detyrimet përkatëse, janë pajisur me çertifikatë pronësie. Bashkia Kukës nuk ka pranuar t'i kalojë Kadastrës shumat e detyrimeve të paguara më parë nga qytetarët, si rrjedhojë ata kanë paguar përsëri për të njëjtin truall.** Në këto kushte qytetarët kanë kërkuar në mënyrë të vazhdueshme kthimin e shumave të paguara më parë, për llogari të Bashkisë Kukës.

Bashkëlidhur ankesës, na është vënë në dispozicion dhe praktika e dokumentacionit që disponon ankuesi për këtë çështje. Nga shqyrtimi i kësaj praktike, evidentohet si më poshtë.

Më shkesën nr. 331/1 datë 12.11.2019 të Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Bashkia Kukës i bëhet me dije qytetëve A. H., E. Gj., B. D., që pas verifikimeve të bëra në regjistrin e arkës të vitit 2009, rezultojnë të dhënat që këta qytetarë kanë kryer këtë pagesë, duke i venë në dispozicion dhe dokumentacionin provues.

Më tej, me shkesën nr. 851 Prot, datë 03.11.2021, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Kukës i drejtohet Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, Bashkia

Kukës duke i dërguar kësaj drejtorie kërkesën për kthim të shumave të paguara për truallin, paguar nga qytetarët në bazë të përllogaritjes së zyrës së urbanistikës, dalë në zbatim të VKB Kukës Nr.24, datë 22.04.2009, duke i vënë në dispozicion dhe dokumentacionin shoqërues provues (kërkesën e qytetarëve, VKB nr. 24, datë 22.04.2009, njehsuar me origjinalin, autorizimin hartuar nga Drejtoria e Urbanistikës, njehsuar me origjinalin, për likuidimin e detyrimit, mandatet e arkëtimit për pagesën e detyrimit)[1] dhe duke theksuar faktin që pas marrjes së vendimit në Këshillin Bashkiak Kukës dhe likuidimit të detyrimit nga qytetarët, *atyre nuk u është lidhur kontrata e shit-blerjes së truallit dhe si rrjedhojë atyre ju lind e drejta për të kërkuar rikthimin e shumës së paguar për truallin.* Në këtë kuptim, Bashkisë Kukës i lind detyrimi për t'i kthyer qytetarëve shumat e arkëtuara.

Në kontradiktë të komunikimit shkresor zyrtar të mësipërm, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit me shkesën nr. 851/1, datë 17.11.2021 në përgjigje të shkresës nr. 851 Prot, datë 03.11.2021, të Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Kukës shprehet se nuk gjen asnjë dokumentacion që vërteton kryerjen e këtyre pagesave nga qytetarët dhe kërkon që problemin e qytetarëve ta zgjidhë Drejtoria Juridike, Prokurimeve Publike dhe IT, *në kundërshtim me sa vërtetohet nga dokumentacioni përkatës.*

Në kuadër të hetimit administrativ për rastin në fjalë, institucioni i Avokatit të Popullit ju është drejtuar me tre kërkesa për informacion/shpjegime[2] me qëllim zgjidhjen e problematikës së qytetarit. Ndonëse kemi cituar me përpikmëri sa kërkohet, duke ju vënë në dispozicion dhe informacionin lidhur me proçedurat e ndjekura nga ana e Bashkisë[3] , nuk ka patur asnjë përgjigje, informacion apo shpjegime rreth shkaqeve të cilat justifikojnë moskthimin e shumës së kërkuar nga ankuesi, në kundërshtim me:

- pikën 4, të nenit 63, të *Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,* ku parashikohet në mënyrë eksplicite se: "Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjithë dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij";

- nenin 19/b të *Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit",* që parashikon se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qëndrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin", si edhe paragrafin e fundit të këtij neni, ku parashikohet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të caktojë një afat për kryerjen e veprimeve të mësipërme.";

Qëndrimi i punonjësve të Bashkisë Kukës, është tregues i shkeljes së parimit të ligjshmërisë, transparencës, informimit, dhënies së ndihmës aktive, drejtësisë dhe paanësisë, përgjegjësisë, deburokratizimit dhe efiçencës, sikurse parashikuar në nenet 4, 5, 6, 10, 13, 14, 15, dhe 18, të Ligjit Nr.44/2015, *"Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë",* të detyrueshme për zbatim në kuptim dhe zbatim të parashikimeve të nenit 1 të këtij Kodi.

Përpos situatës së prezantuar, konstatohet se punonjësit e Bashkisë Kukës nuk kanë përmbushur detyrimin ligjor në marrëdhënien me institucionin e Avokatit të Popullit, duke u bërë në këtë mënyrë pengesë për institucionin e Avokatit të Pupullit në ushtrimin e detyrës për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme

[1] *VKB nr.24, datë 22.04.2009 miraton sheshin e ndërtimit , për ndërtim objekti" Shtesë pallati për banim 5 kat" me adresë l.6, pallati nr.11, Kukës, për banorët: Astrit Hoxha, Besim Duraku, Enver Gjana, Fatri Braha, Avni Avdia.
*Autorizim i Bashkisë Kukës, Drejtoria e Urbanistikës, banorëve për likuidimin e detyrimeve,për pagesën e truallit, në zbatim të ligjit 8045, datë 17.09.1998/ neni 55, "Për Urbanistikën".
*Kopje e librit të arkës, Bashkia Kukës; Arkëtimet e muajit Dhjetor 2009, ku pasqyrohet shuma e arkëtuar nga ankuesi.

[2] Shkresa nr. K1/B15-2 Prot, datë 23.11.2022 "Kërkesë për shpjegime", shkresa nr. K1/B15-4 Prot, datë 20.12.2022 "Kërkësë e përsëritur për shpjegime", shkresa nr. K1/B15-5 Prot, datë 15.02.2023 "Kërkesë e përsëritur për shpjegime"

[3] Bashkëlidhur shkresës nr. K1/B15-5 Prot, datë 15.02.2023 "Kërkesë e përsëritur për shpjegime"është dërguar dhe dokumentacioni që shoqëron ankesën.

e të parregullta të organeve të administratës publike, në mënyrë sa më efiçente dhe në një afat sa më të arsyeshëm.

Parë në këtë këndvështrim, Avokati i Popullit vlerëson se është e nevojshme marrja e masave për një vlerësim serioz të mënyrës sesi trajtohen nga institucioni i Bashkisë Kukës çështjet që prekin të drejtat e qytetarëve, duke patur një qasje proaktive, bashkëpunuese dhe shkëmbim të plotë dhe shterues të informacioneve të nevojshme bazuar në përcaktimet ligjore, për zgjidhjen e rasteve që i përkasin qytetarëve.

Për sa më lart, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin sanksionohet se: *"Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozoje masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata Publike",* dhe nenet 21, 22 e 22/1 të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 *"Për Avokatin e Popullit",* të ndryshuar,

R E K O M A N D O J M Ë

- *Trajtimin e kërkësës/ankesës së qytetarit për të vënë në vend të drejtën e kthimit të shumës së kërkuar, paguar për llogari të Bashkisë Kukës, pas marrjes së vendimit të Këshillit Bashkiak për moslidhjen e kontratës së shitblerjes së truallit.*
- *Koordinimin dhe rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional si dhe marrjen e masave për një vlerësim serioz të mënyrës sesi trajtohen nga institucioni juaj çështjet që prekin të drejtat e qytetarëve, duke patur një qasje proaktive, bashkëpunuese dhe një shkëmbim të drejtë e shterues të informacioneve të nevojshme për zgjidhjen e rasteve që i përkasin qytetarëve.*
- *Marrjen e nismës për fillimin e procedimit disiplinor ndaj punonjësit/ve të Bashkisë Kukës që nuk ka/kanë përmbushur dhe nuk përmbush/përmbushin detyrimin ligjor në marrëdhënie me Institucionin e Avokatit të Popullitm apo me subjektin ankues*.

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit "Për Avokatin e Popullit", ku thuhet shprehimisht se: **"*Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit*",**

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

Me urdhër dhe porosi

KOMISIONERI

AHMET PRENÇI

DV